




Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Klokot-Vrbovc/Opština Klokot-Vrbovac

Vendi I takimit	Lokalitetet e Kuvendit Komunal në Klokot
Data	28.12.2018

Në bazë të nenit 43.pika (43.1,43.2,43.3,43.4,43.5)Ligjit për Ëeverisje Lokale 03/L-040,si dhe statutit komunal sipas nenit 18.Është mbajtur séance e dymbëdhjetë e rregullt e kuvendit komunal Klokot-Vërbovc për vitin 2018 , me rendin e ditës të përcaktuar . Me atë rast është bërë si në vijim :

PROCESVERBAL NGJA SEANCA E DYMBËDHJETË E RREGULLT E KUVENDIT KOMUNAL KLOKOT-VËRBOVC PËR VITIN 2018

Seancën e udhëheqi kryesuesi I kuvendit komunal Klokot-Vërbovc z.Zarko Dejanovic.

Në fillim, Kryesuesi përshëndeti të gjithë delegatët, qytetarët, drejtorët, përfaqësuesit e të OSBE-së z. Sasha Mirkoviç.

Pas thirrjes u konstatua se kishte kuorum për punën e séances

Antarë present 14

Kryesuesi Zarko Dejanovic: Z. Delegat, shpresoj se ju keni marrë materialin e nevojshëm për seancën e sotme, para se të pyes nëse dikush dëshiron plotësim apo ndryshim në rendin e ditës , kam një shtesë që kam marrë nga Nijaza Fejza, pasi një antarë I komisionit për komunitete ka vdekur , kam marë një shkresë me shkrim ku ata po propozojnë të jenë një kandidat i ri në komisionin për komunitete, e që aji është Isat Rexhepi A dëshiron dikush të thotë diçka lidhur me këtë pikë .

Për fjalë u paraqit Hidajet Ahmeti: Përshëndetje për nënkryetarin , kryesuesin e kuvendit , dele gatët dhe të gjithë të pranishmit këtu . Lidhur me rastin të cilin e kemi cekur këtu dëshiroj të ju shpreh ngushllimet e mija publikisht . Ndërsa sa I përket antarit tjetër që do të jetë në vend të tijë do të ishte mirë të ishin dy ose tre emra , unë dua të theksoj se kam respect për kandidatin e ri I cili është

propozuar por dom të ishte mirë të dalim me dy tre emra dhe të votohet këtu kandidati më i votuar si antar për komunitete .

Kryesuesi Zarko Dejanovic:

Z. Hidajet këtu është një formë e plotsuar dhe e nenshkuar nga qytetaret se kend dëshirojn të jetë kandidat dhe ka marrë mbështetjen e dhjetë njerëzve ,dhe të gjitha janë në përputhje me ligjin, kjo çështje ishte në komisionin për komunitete. Nijazi Fejz më dha këtë listë mua nëse doni do ta shtyjim këtë pikë. Ky është sugjerimi imë ende nuk ka hyrë si pikë në rendin e ditës .

Hidajet Ahmeti: Nëse shkojmë ligjërisht, nëse po flasim për ligjin duhet të jetë bërë një takim për një njoftim publik në fshatin Mogila nga komuniteti shqiptar .

Nijazi Fejza: Ne kemi mbajtur një debat publik, ka pasur edhe njoftim.

Hidajet Ahmeti:Mendoj se ai duhet të jetë përfaqësues i një komuniteti dhe subjecti -jopolitik.

Kryesuesi Zarko Dejanovic: z. Nijazi, a është kjo nga lista e qytetarëve?

Nijazi Fejza: Po, ai nuk merr pjesë në ndonjë parti politike.

Hidajet Ahmeti: Unë mendoj se do të ishte mirë për zgjedhjen e kandidatit që të jenë dy , tre për përzgjedhje .Në mesin e atyre që kan qenë të interuar në rastin e parë ishte Hajrush Shaqiri në mandatin e kaluar .

Për fjalë u paraqit Shqiprim Rexhepi: Unë nuk e di pse po e shqyrtojm kaq gjat , kur ne akoma nuk kemi nënkryetar për komunitete , unë mundem ta propozoj dikend tani ja aji është Artur Rexhepi

Kryesuesi Zarko Dejanovic: z.Shqiprim do të duhet të sjellni një formular të këtij lloji dhe ky është zyrtar nuk është propozim , kjo është mbështetja e qytetarëve të komunitetit shqiptar . Ju nëse e keni ndonjë kandidat për ta propozuar duhet të kërkon mbështetjen e qytetarëve tuaj . A është kështu z.Hidajet.

Hidajet Ahmeti: Problemi është se nuk ka pasur njoftim publik .

Kryesuesi Zarko Dejanovic: z.Njazi a qëndroni pas kësaj kërkesë .

Nijazi Fejza: Vendoseni në votim .

Kryesuesi Zarko Dejanovic: z. delegate kush është PËR që ky propozim të hyn në rend dite .10 ishin për të tjerët nuk u deklaruan . Konstatojm se se e kemi miratuar këtë propozim për të hyrë si pikë e rendit të ditës . Aji është delegate për komisionin për komunitete . A dëshiron edhe dikush ndonjë ndryshim apo plotësim .

1.Miratimi i procesverbalit nga séance e njëmbëdhjetë e rregullt e Kuvendit komunal për vitin 2018

2. Raporti i punës së Kuvendit komunal për vitin 2018 ;

3. Raporti I Kryetarit komunal për situatën ekonomiko –financiare dhe situatën e planeve investive nga viti 2018 ;

4. Të ndryshme

Kryesuesi Zarko Dejanovic: zotërinj delegate kush është për miratimin e rendit të ditës së sotme , 13 ishin për , konstatoi se e kemi miratuar rendin e ditës së sotme.Kalojm në pikën e parë të rendit të ditës , ajo është : **Miratimi I procesverbalit nga séance e njëmbëdhjetë e rregullt e Kuvendit komunal për vitin 2018;** A dëshiron dikush të thotë diqka lidhur me procesverbalin .Kush është për miratimin e procesverbalit ? , 10 janë për , konstatoi se e kemi miratuar pikën e parë të rendit të ditës .Kalojm në pikën e dytë të rendit të ditës ; ajo është Raporti I punës së Kuvendit komunal për vitin 2018 ; .z.delegat ju e keni marrë materjalin ju e keni pare se si ka punuar kuvendi I ka miratuar vendimet dhe dy akte ligjore jut ë gjitha këto I keni të dokumentuar tek ju , dhe nuk ka nevoj që unë tani të ju lexoj të gjitha këto që ne I kemi bërë , nëse dikush dëshiron diqka për të thënë ne të urdhëroj . Pasi e shof se askush nuk ka asgjë për të thënë , kalojm në pikën e tretë të rendit të ditës , ajo është **Raporti I kryetarit komunal për situatën ekonomiko –financiare dhe situatën e planeve investive nga viti 2018 ;**

Për fjalë u paraqit Nënkryetari z.Sasa Mirkovic : Të nderuar delegate të nderuar përfasues të OSBE-së të nderuatë kolegë , drejtor dhe të ndëruarë qytetar . Unë mendoj se viti 2018 ka qen vit punues dhe mjaft pozitiv , gjithsesi se gjithsesi se kishte vështërsi por lirisht mund të them se ne si qeverisje egzekutive I kemi realizuar të gjitha ato që ishin të shënuara në 2018 . Unë si zëvendës I kryetarit dhe pran kabinetit të kryetarit nuk do të zgjatem shumë në fjalim por do ti jap fjalën Dragishës dhe aji do të prezantoj të gjitha ato që janë bërë në vitin 2018 , por nëse flasim për shpenzimin e buxhetit , buxhetin e kemi shpenzuar 90% kështu që asgjë nuk është kthyer në suficit nëse ishtenë vitin 2018 I planifikuar nga qeverisja e kaluar , edhe pse mandatin e kaluar mjetet financiare kanë shkuar në suficit e që kjo do të thotë një m,enagjim I keq . Unë shpresoj se në vitin 2019 do të hapim edhe disa vende pune dhe të ju sherbejm qytetarëve shumë më mirë .

Për fjalë u paraqit Dragisa Kojic: Faleminderit Nenkryetar , Kryetar i Kuvendit, përshëndetje anëtarë të kuvendi kryesues I Kuvendit Komunal dhe të gjithë të pranishmit në sallë. Ky është raporti i dytë mbi situatën ekonomike dhe financiare të planeve të investimeve në vitin 2018, të parin e kishim në muajin korrik dhe pastaj kemi dhënë disa aktivitete të cilat mendojm se do të behen deri në fund të vitit, ky është një raport më shumë në kuptimin teknik, ku të gjitha këto aktivitete u zhvilluan nga ato të planifikuara 7 kemi bërë 15 aktivitete dhe 7 nga 15 projekte .Para se të filloj me prezantimin e këtij raporti, raporti ka një pjesë hyrëse të komunës sonë ose një anatomi të cilën jemi ne , pjesa tjetër përbëhet nga një natyrë financiare dhe e treta është një prezantim analitik duke investuar kapitalin në investime kapitale .

Këtu shihen kufijtë e komunës tonë prej formimit të komunës tonë, ne shohim se kemi një popullatë shumetnike dhe shtrihemi në 23 kilometra katrorë në 4 zona kadastrale, 800 deri 950 banorë, kufizohet vetëm me komunën e Vitisë dhe kështu kemi një pasqyrë të popullatës sonë, këto janë të dhënat e marra nga agjencia statistikore këtu shohim në silën zonë dhe cila është zona kadastrale në hektarë ,Mogila është një nga zonat kadastrale më të mëdha në territorin e komunës, Vrbovci është një

nga më të vegjlit, megjithatë, si komunë me të cilën jemi formuar me 5050 banorë dhe menjëherë ju them lista që është bërë në vitin 2012 nuk është reale në asnjë mënyrë, sepse nuk i keni numëruar banorët në buxhet, ju mund të shihni që kemi 2500 banorë të numëruar dhe komuna jonë është dëmtuar për rreth 100,000 euro në buxhet, në vitin 2021 do të jetë regjistrimi i dytë i popullsisë dhe atëherë do të dimë se sa banor kemi në komunës tonë me numër të ri.

Situata aktuale me administratën komunale me të cilën ne kemi në amogram të komuës i kemi mundësuar komunës që të ketë 5 departamente të parapara si nënkryetarit të komunës për komunitete i cili ende nuk është i punësuar, kemi zyrën e nënkryetarit, kuvendin, dhe ju mund të shihni se këto janë komitete të detyrueshme që janë në statut të kuvendit, komisionin për politikë dhe financa dhe komisionin e komunitetit, ju keni raportet e kryetarit të kuvendit, në të cilat shihet se qka është punuar komisionet gjatë vitit të dyja komisionet dhe sa seanca janë mbajtur, dhe keni një detyrim për komitetin për siguri në komunitet që është nën kabinetin ekzyetarit. Ne kemi marrë statutin e ndryshuar që ju keni votuar për të dhe statuti parashikon 9 departamente, kështu që kjo foto do të jetë ndryshe në vitin 2019. Janë shpallur konkurse në vitin 2018 për dy vende pune për shërbyes civil, mund ta shifni dhe e keni në material se cilat janë ato pozita të cilat mund ti vertetoni personalisht në shërbimet e personelit poashtu edhe këto shenime janë marrë nga zyra komunale e personelit, komuna ka akoma vende të pa plotësuara sepse nuk jami në përberje të plotë me buxhet, por shpresojmë se do të kompletohemi në vitin 2019, kjo është lista e puntorëve se kush cilën detyrë e kryen në komunë dhe ky është shërbimi i civil e cila ka punar dhe kontribuar në vitin 2018. Unë dua të ju kujtoj se ky raport i është dorëzuar ministrisë së pushtetit lokal për kuvendin komunal për vitin 2018, dhe mund ta shifni se Kuvendi komunal është shumë efektiv, kishte 49 aktivitete nga të cilat janë realizuar plot 49 dhe keni pasur dy akte ligjore të cilat i keni shqyrtuar dhe miratuar po ju rikujtoj se këto janë statuti i kuvendit komunal dhe Rregullorja e tatimit në pronë për vitin 2019.

Këto janë vendimet e kuvendit të cilat ju i delegate i keni miratuar gjatë vitit 2018. Janë gjithsejt 35 me vendimin e vitit 2017 për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit, vendimi i parë nga 2017 sepse atëherë është bërë rikonstruimi i kuvendit komunal. Sa i përket raportit të kuvendit komunal dhe planeve të veprimit në kuvend ishte shqyrtuar raporti gjashtmuor për situatën ekonomiko financiare financiare plani akcionar për transparencë dhe pjesëmarrja në planifikimin e buxjetit këtu janë paraparë të gjitha debatet publike para miratimit të buxjetit pas kësaj kemi miratuar buxhetin afatmesëm komunal, i planifikuar nga harkorja buxhetore si dhe kornizën afatmesme. Buxheti komunal kishte mjetet e veta financiare në investimet kapital të cilat i kanë propozuar qytetarët në debatet publike. Nga ato planifikime janë bërë 15 projekte kështu që do të kemi rastin ti shohim se cilat janë ato projekte por është e nevojshme ta cekim se në dispozicion i kishim 1.221.387€ në buxhet, ku pjesa më e madhe shkon në paga dhe mëditje siq po e shifni në pjesë tjetër prej 123,736, në mallra dhe shërbime, shpenzimet komunale dhe subvencionet një pjesë dhe shpenzimet kapitale sipas buxjetit të vitit 2018 nga të hyrat vetanake janë 131,461 të cilat janë shpenzuar në vitin 2018. Ju mirë e dini se atë tatimpaguesin të cilin e keni votuar për pagesat e taksës denimeve dhe ngarkesave dhe këto rregullore të tilla shfrytëzohen në shërbimet tona bëhen pagesat për tatim dhe tatimin në pronën e palujtshme sepse gjithsejt janë mbledhur 56,716 evra, mund ta shuiqoni në tërësi në këtë sajt ku i keni mbledhur të gjitha tatimet që përbëjnë shumën prej 114,573 €, ju keni votuar në kuvend, ta cek se është miratuar

vendimi për bartjen e të hyrave . Kjo është një fotografi sociale e komunës tonë ku ne edhe tutje kemi një numër të madhë të ndihmës sociale , këtu mund të shihni në vitin 2018 kemi bërë projekte për riparimin e rrjetit të ndriqimit rrugor në fshatin Grnqar dhe Vërbovc , largimin e të gjitha deponive të egra dhe riparimi i parqeve , projekti i 15 është i fundit kur është marrë paisja për shkolla , ju mund të shihni se gjithsejt janë 435,412 të investara në projektet kapitale. Nga këto 346,445 janë investuar nga buxheti komunal . Ndërsa 88,967 € janë donacione . Në fillim të ndrrimit të udhëheqsisë është ardhur deri tek shpërndarja e kontenjerëve në teritorin e komunës dhe më pas kemi filluar me hartimin e projekteve , janë asfaltuar të gjitha rrugët në teritorin e komunës , rregullimi i qendrës së fshatit Vërbovc , , ndriqimi rrugor në Vërbovc dhe Grnqar , rikonstruimi i kopshtit të fëmijëve në Vërbovc , pastrimi i të gjitha depinive të egra e cila është financuar nga ana e komunitetit për kthim .

Kryesuesi Zarko Dejanovic : e falenderoj Dragisha Kojic

Për fjalë u paraqit Shqiprim Rexhepi: Vetëm një project hyn në Mogillë dhe të gjitha mjetet janë shopenzuar ndërsa ne nuk kemi kushte për punë në kuvend dhe po mërdhihem .

Për fjalë u paraqit Hidajet Ahmeti: Unë pajtohem me Shqiprimin se Mogilla është e diskriminuar , unë do të dëshiroja që viti 2019 të ketë më shumë investime në Mogillë , për shkak se aty jetojnë serb edhe Shqiptar . Kam vërejtje në Dragishën sepse mendoj se aji e ka bërë hartimin e planit , aji i paraqitur statistika këtu por statistika zyrtare 2019 dhe 2020 nuk i ka prezantuar , unë e di se ka qenë një bojkot nga ana e komunitetit serb dhe statistikat nuk janë reale , por duhet të jenë të dhënat zyrtare me të cilat institucioni komunikon dhe debaton me ato të dhëna . Unë personalisht kam pasur problem për kohën që kam qenë drejtor , sepse e vërteta është ndryshe ndërsa të dhënat zyrtare janë ndryshe . Edhe tek subvencionet dhe transveret edhe një vërejtje është marrë nga ana e auditorit general për rregulloren e shpërndarjes ose ndarjes së subvencioneve dhe transverëve edhe ne si kuvend komunal kemi pasur për obligim për ta shqyrtuar këtë vërejtje edhe për hargjimin e të gjitha mjeteve për vitin 2018 dhe me ato të dhëna të vihet me një plan operativ , duke pasur parasysh ato gabime që janë bërë kemi një përparsi në vitin 2018 grandet qeveritare nuk kanë shkuar në suficit , këtu shihet se është një menagjim i mirë është menagjuar me mjetet dhe është punuar mirë .

Për fjalë u paraqit Nënkryetari Sasa Mirkovic: Më duhet disa gjera ti demantoj dhe disa tit i mbështes , ndoshta kryetari do të thoshte më shumë lidhur me këtë qështje po mirë unë 805 do të flas edhe unë . edhe unë e njoh situatën, pajtohem me Shqiprimin se kushtëet nuk janë të përkryera por shpresoj se séance tjetër e kuvendit të mbahet në komunën e re , punimet janë duke përfunduar , kjo nuk është ngecje e jona kjo ndërtesë po ndërtohet veq 10 vite dhe ky është një turp për të gjitha institucionet e Kosovës , fatkeqsisht është dashur më herët të kalohet aty dhe të funksionalizohet . Sa i përket diskriminimit kjo është një fjalë e rëndë Hidajet unë jam i sigurt se dikund ka qenë më shumë e dikund më pak dhe unë e di se në Vërbovc dhe në Grnqar është ndërtuar më shumë por në Kllokot edhe pse unë jam nga Kllokoti dhe ti nga Mogilla . Por e kemi buxhetin edhe për vitin e ardhshëm kuptohet në të cilin kemi qenë të gjithë të kyqyr në hartimin e buxhetit dhe do të rendisim mjetet në mënyrë të barabartë . në mënyrë që fshatrat tona të jenë të rregulluara dhe më të bukura . Kur unë kam qenë Kryetar komune unë më së shumti kam investuar në Mogillë vetëm në një vit kam investuar 7000 .000€ në ndërtimin e rrugës Mogill –Vërbovc , ndërtimin e ambullantës , rrjetin e kanalizimit , ndriqimin rrugor . Buxheti i cili ka qenë

në vitin 2018 ishte nga udhheqsija e kaluar dhe ne nuk kemi mundur të benim asgjë për ta ndryshuar atë ne vitin 2019 por siq ishte I planifikuar ashtu edhe do të implemntohet kspitali. Do të mundohemi që nga qeverija e Kosovës të thithim mjete të caktuara nëse nuk mundemi ti plotësojm nga bugjeti komunal , unë vetëm se kam biseduar me disa zëvdësministra që vitin 2019 do marrim më shumë mjete nga Qeverija e Kosovës dhe do ti përfundojm shumë projekte kapitale. Sa I përket subvencioneve në vitin 2017 janë shpenzuar 27.000€ për një muaj dhe e di se ishte viti I kampanjeës zgjedhore kjo është një plolitikë dhe unë e kuptoj. Ne këtë vit kemi pasë shumë pak mjete tek subvencionet dhe jemi munduar ti japim më të rrezikuarve dhe atyre që kishin më së shumti nevoj, sa I përket suficitit këtu pajtohem sepse asgjë nuk është kthyer prapa në qeveri siq ka shkuar ndoshta më herët , kjo është kjo .Faleminderit .

Për fjalë u paraqit Hidajet Ahmeti: Unë kam qen kundër për shumën e ndarë por menyra se si është ndarë është transparenca rregullorja sepse ka ardhur deri tek vërejtjet e auditoerit .

Për fjalë u paraqit Shqiprim Rexhepi: Ne kemi votuar për të gjitha por ne si komunitet Shqiptar nuk kemi arritur asgjë nga ky kuvend sepse ne akoma nuk kemi një zëvendëskryetar tonin , shpresoj që në vitin 2019 në seancën e parë të jetë zgjedhja e nënkryetarit për komunitete .

Për fjalë u paraqit Afize Rexhepi: Siq e ceka edhe në komisionin për plitikë dhe financa dua të kem qasje në listën e pagave të puntorëve . Dhe e keni një gabim tek përparimi Shef I Prokurimit aty thuhet se është hapur konkursi ndërsa perasoni vetëm se është duke punuar.

Për fjalë u paraqit Dragisa Kojic:E di se cka dëshironi të thuani e kuptoj aji është një vend pune I lenë si I hapur ndrkohë që ne e kemi pranuar Perparimin Rexhepin shef të prokurimit , shërbimi I përasonelit Skender Hoda mi ka dhënë vetëm sherbimet me ata kode të cilat kan mjete të lira për tu paguar për 5 vende pune ndërsa ne këtu e kemi paraqitur 50 vende pune ndërsa duhet të jenë 55 për ta mbushur shërbnin public , tani ajo pozitë është e plotësuar egziston pozita tjetër e cila duhet të vijë në atë pozitë të pestë ne kemi të drejtë ti kemi të punsuar 55 puntor , stafi politik dhe shërbyes civil .

Kryesuesi Zarko Dejanovic: z.delegat po e jap në votim pikën e tretë të rendit të ditës : **Raporti I kryetarit komunal për situatën ekonomiko –financiare dhe situatën e planeve investive nga viti 2018 ;Kush është për miratimin e kësaj pike** , për këtë raport , 11 votuan për , të tjerët nuk u deklaruan , konstatoj se këtë pikë e kemi miratuar .

Kalojm në pikën e 4 të rendit të ditiës , kandidati për komisionin e komuniteteve Esat Rexhepi kush është për që ky kandidat të jetë antarë I Komisionit për Komunitete , 10 votuan për , të tjerët nuk u deklaruan .Konstatoi se kjo pikë është miratuar . Të nderuarë delegate nën pikën **Të ndryshme** , a dëshiron dikush të marrë fjalën .

Hidajet Ahmeti: Kryetari nuk është këtu edhe drejtori I arsimit nuk është , kam pyetje për rastin e shkollës në Mogill , unë e di se nxënësit e komunitetit serb mbajn mësim në shkollën e vjetër pse jo edhe komuniteti Shqiptar , sepse kjo shkollë ka qen model për të gjitha shkollat në teritorin e Kosovës në kuptimin e shkollës multietnike .Kjo pyetje është për ktyetarin dhe drejtorin e arsimit.

Nënkryetari Sasa mirkovic:Pasi që edhe unë kam qen I kyqyr në këtë , kemi biseduar me OSBE, në për këtë qështje shkolla e cila ka qenë shembull e multiethnive do të mbetet prap shembull , gjithsesi nga viti I ardhshëm edhe nxënësit Shqiptar edhe ata serb do të shkojnë në shkollë sëbashku .

Në fund kryesuesi e mbylli seancën e dymbëdhjetë të rregullt të Kuvendit Komunal Kllokot-Vërbovc për vitin 2018.

Data: **28.12.2018**

Kryesuesi I Kuvendit KOMunal Kllokot-Vërbovc



/Zarko Dejanovic/